



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
“ISA BOLETINI”
MITROVICË

Nr. Prot. 1989 Dt. 04.10.2023

Senati i Universitetit “Isa Boletini” Mitrovicë në bazë të kompetencave sipas nenit 98 dhe 99 të statutit, në mbledhjen e mbajtur me 04.07.2023 ka miratuar propozimet e njësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2023/2024 dhe ka miratuar kriteret për regjistrim në studimet master. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga senati gjithashtu janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me shkresën nr. prot. 2749 datë 07.07.2023

KONKURS PLOTËSUES –AFATI I DYTË

Për plotësimin e vendeve të paplotësuara nga afati i parë i konkursit për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve Master në vitin akademik 2023/2024

1. Universiteti “Isa Boletini” Mitrovicë (UIBM), në studimet master, për vitin akademik **2023 – 24** do të regjistrojë **55** studentë.
2. Brenda numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij konkursi, duke u bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHT – it, UIBM do të regjistroj deri në 12 %, përkatësisht deri në **8** studentë të rregullt nga komunitetet jo shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.

I. KUSHTET E PËRBASHKËTA TË KONKURSIT

1. Në studimet master në Universitetin “Isa Boletini”, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët të cilët i kanë mbaruar studimet themelore – bachelor në Universitetin “Isa Boletini”.
2. Të drejtë pranimi në Universitetin “Isa Boletini” kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës. Në raste të tilla kandidati duhet të sjellë dëshminë (vërtetim apo vendim) mbi akreditimin e institucionit në të cilin i ka mbaruar studimet paraprake. Në pamundësi të sigurimit të dëshmisë për akreditim, atëherë statusi i këtyre programeve do të konfirmohet nga zyra për sigurim të cilësisë e cila gjendet në Rektorat. Vendimi për njohjen dhe për barasvlerën e diplomës të fituar jashtë Kosovës, merret nga MASHTI, ndërsa barasvlera e notave do të bëhet nga zyra për sigurim të cilësisë e UIBM.
3. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet master në një program tjetër. Në rast pranimi, Këshilli i njësive akademike, në propozim të Komisionit të Studimeve, mund të caktojë provime diferenciale të cilave duhet t’iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Numri i provimeve caktohet varësisht nga shkalla e kalueshmërisë/ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit. Në raste të tilla, kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe iu nënshtrohen provimeve duke filluar në afatin e janarit, prillit, qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri në pesë provime diferenciale të cilave do t’iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh ndërsa procesverbalet e provimeve ratifikohen nga Këshilli i njësive akademike përkatëse.
4. Përrjashtim nga paragrafi 3 i këtij konkursi bëhet për programet studimore me specifika të veçanta, të cilat i përcaktojnë vet njësitë akademike.
5. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të UIBM, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UIBM, pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1



UNIVERSITETI - UNIVERSITY "ISA BOLETINI" MITROVICË

6. Kandidatët për pranim si studentë të UIBM, në vitin akademik 2023/2024, nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet apo program.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për pranim në studimet master deri në numrin e përcaktuar sipas këtij konkursi bëhet sipas ranglistës prioritare të notës mesatare të arritur gjatë studimeve 7.50 e më lartë.
2. Në rastin kur numri i kandidatëve është më i vogël se numri i paraparë me konkurs, atëherë mund të pranohen edhe kandidatë me notë mesatare më të ulët se 7.50, por ata do t'i nënshtrohen provimit pranues. Rangimi i kandidatëve në këtë rast bëhet në bazë të: a). Notës mesatare gjatë studimeve dhe b). Rezultateve të provimit pranues. Provimi pranues organizohet nga fakultetet dhe mbahet nga lëndët të cilat i përcaktojnë vetë fakultetet, por jo më shumë se tri lëndë. Numri maksimal i pikëve të arritura në provimin pranues është 100. Kriteret dhe kushtet e provimit pranues i përcaktojnë fakultetet.
3. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve, të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve, është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve deri në numrin e planifikuar për pranim, do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm në studimet themelore bachelore. Nëse edhe pas kësaj do të kemi rezultat të njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Në rastin kur organizohet provimi pranues përparësia e studentëve fillon nga numri i pikëve të fituara në provimin pranues, pastaj suksesit të përgjithshëm në studimet themelore bachelore dhe në fund përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Nëse edhe pas këtij kriteri numri i pikëve mbetet i barabartë atëherë zgjedhjen e kandidatëve do të bëjë komisioni përkatës i fakultetit.
4. Fakultetet janë të obliguara që tërë listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Universitetit.

III. AFATET KONKURSIT

Për aplikimin dhe regjistrimin e studentëve oraret do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 05.10.2023 deri me 13.10.2023 në ora 16.00 (dokumentet do të pranohen vetëm ditëve të punës).
2. Aplikimi online do të funksionalizohet prej ditës së parë të konkursit.
3. Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:
 - Fletëparaqitja e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (Linku) për aplikim Online përmes Internetit është: www.umib.net**
 - certifikatën apo ekstraktin e lindjes (origjinal);
 - kopja e letërnjoftimit;
 - diplomën – certifikatën e diplomimit, (origjinal ose të noterizuar).
 - dëshminë e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit dhe në kolegjet private të Republikës së Kosovës);
 - pasqyrën e provimeve të dhëna me notë mesatare, (vetëm për kandidatët nga programe dhe fakultetet tjera);
 - Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.
1. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 1. Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit dhe fotografimit.
 2. Letërnjoftimin.
 3. Bazuar në udhëzimin administrativ nr 09/2021 studentët që regjistrojnë semestrin për herë të parë është pa pagesë.
4. **Provimi pranues do të mbahet më 16.10.2023 nga ora 10**
5. **Të gjithë kandidatët janë të obliguar që të kenë me vete letërnjoftimin ose pasaportën. Kandidatët nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues pa dokument identifikimi. Kandidatët**



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

të cilët nuk paraqiten në kohën e caktuar për mbajtjen e provimit pranues, sipas orarit të shpallur, nuk do të lejohen të marrin pjesë në provim. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!

6. Shpallja e rezultateve preliminare bëhet më **16.10.2023**. Rezultati preliminar nuk nënkupton pranimin përfundimtar të kandidatëve, pasi që rezultati përfundimtar pas shqyrtimit të ankesave mund ta ndryshojë listën e kandidatëve të pranuar.

IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve master mund të ankohen kundër vendimit brenda tri ditëve të punës pas shpalljes së rezultateve të përzgjedhjes. Ankesat i drejtohen komisionit për pranimin e studentëve. Vendimi përfundimtar rreth ankesave merret nga komisioni për shqyrtimin e ankesave.

V. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE DHE REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

1. Rezultatet përfundimtare në bazë të vendimit të komisionit të ankesave shpallen më së largu deri më **20.10.2023**
2. Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet prej **23.10.2023** deri me **24.10.2023**, prej orës **9:00 – 15:00**.
3. Kandidatët e pranuar për regjistrim paraqesin:
 - Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit;

Për informata të tjera të nevojshme, kandidatët mund t'i drejtohen fakultetit përkatës ose nëpërmes adresës: info@umib.net

Numri i studentëve për regjistrim sipas fakulteteve dhe programeve të studimit

Fakulteti – Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë	Gjithsej
Fakulteti i Gjeoshkencave	37	6	43
- Xehetari	8	2	10
- Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike	13	2	15
- Materiale dhe Metalurgji	7	1	8
- Me specializimet: 1: Materiale, 2: Metalurgji			
- Vendburimet minerale	9	1	10
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	10	2	12
- Teknologji: Specializimi: Inxhinieri e Mbrojtjes Mjedisore	1	1	2
- Teknologji: Specializimi: Inxhinieri Kimike	9	1	10

